

VENDIM
Nr. 250, datë 25.11.2024

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË
“PROCEDURAT REZERVË PËR BASHKIMIN E TREGUT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE TË DITËS NË AVANCË SHQIPËRI-KOSOVË”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nën pikës 3.5 të pikës 3 të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 519, datë 13.7.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 3, pika 8 të Rregullores së kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Energjisë Elektrike (NEMO), si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO-s dhe të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në Tregun e Bashkuar, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 40, datë 6.3.2020; neneve 15 dhe 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe “Marrëveshjes kornizë mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës”, të datës 21.10.2021, nënshkruar nga ERE, Zyra e Rregullatorit për Energji e Kosovës (ZRRE), Operatori i Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë (OST) sh.a. dhe Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT) sh.a; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.11.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1899/3 prot., datë 25.11.2024, të përgatitur nga drejtoritë teknike “Mbi fillimin e procedurës lidhur me shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a. për disa shtesa dhe ndryshime në “Metodologjinë e shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni i energjisë elektrike ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës” dhe “Procedurave rezervë për bashkimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri–Kosovë”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 101, datë 27.5.2024, ka miratuar “Procedurat rezervë për bashkimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri–Kosovë”.
- OST sh.a. me shkresën nr. 4536/2 prot., datë 10.9.2024, me lëndën: “Përcjellëse e propozimit të Metodologjisë së Shpërndarjes së të Ardhurave nga Kongjestioni ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës” dhe “Procedurat rezervë për bashkimin e tregut të energjisë elektrike brenda së njëjtës ditë Shqipëri–Kosovë”, ka kërkuar miratimin e ndryshimeve në këto dy dokumente.
- ERE, me shkresën nr. 4536/2 prot., datë 30.9.2024, ka kërkuar nga shoqëria OST sh.a. që të evidentojë shtesat dhe ndryshimet e propozuara që për secilin ndryshim të propozuar të paraqiten argumentet dhe arsyet përkatëse, për të mundësuar vijimin e procedurës në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.
- Më tej, OST sh.a., me shkresën nr. 4536/4 prot., datë 31.10.2024, me lëndë: “Kthim përgjigje lidhur me shkresën tuaj nr. 1899/1 prot., datë 30.9.2024”, ka propozuar disa shtesa dhe ndryshime.
- Ndryshimet e propozuara nga OST sh.a. përfshijnë disa shtesa dhe përmirësime në procedurat rezervë për tregun e përbashkët të energjisë ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, si më poshtë cituar:
 - Në titull, pas togfjalëshit “të ditës në avancë” propozohet të shtohen fjalët: “dhe bashkimit të tregut të energjisë elektrike brenda së njëjtës ditë”.
 - Në pjesën hyrëse (“Duke pasur parasysh që:”),
 - Neni 6, pika 5, është: “Në bazë të nenit 6.5 të Marrëveshjes Kornizë, rregullatorët do të marrin parasysh kërkesat e iniciativave rajonale në nivel të Komunitetit të Energjisë dhe do të konsultohen, bashkëpunojnë ngushtë dhe bashkërendohen me njëri-tjetrin, me qëllim që ato të miratohen pak a shumë në të njëjtën kohë. Të dy rregullatorët, nëse e konsiderojnë të nevojshme, mund të bien dakord të zhvillojnë dhe të nënshkruajnë një marrëveshje specifike që kërkon organizimin e konsultimeve të përbashkëta publike dhe duke siguruar që të gjithë termat, kushtet dhe metodologjitë e parashikuara në nenin 6.4 të miratohen me të njëjtën përmbajtje identike. Pas fjalive “bashkimit të tregut të ditës në avancë Shqipëri–Kosovë nuk është në gjendje që të prodhojë rezultate”, shtohen fjalët: “dhe për IDA

(bashkimit të tregut të energjisë elektrike brenda së njëjtës ditë Shqipëri–Kosovë) për një sistem të përbashkët komunikimi rezervë”.

- Pika 7 është: “Procedurat rezervë reflektojnë dispozitat mbi parimet e përgjithshme të pasqyruara në rregulloren e Komisionit (BE) 2015/1222 të 24 korrikut 2015, për krijimin e një udhëzuesi për alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongestionit (“Rregullorja CACM”).” Në fund shtohet një fjali me këtë përmbajtje: “Ndërsa për IDA-në (bashkimit të tregut të energjisë elektrike brenda së njëjtës ditë Shqipëri–Kosovë) procedura rezervë do të zbatohet për një sistem të përbashkët komunikimi rezervë.”

- Pika 9 është: “Afati kohor i propozuar për zbatimin e këtyre procedurave rezervë do të përfshihet dhe mund të gjendet në Rregullat e Alokimit të Kapaciteteve nëpërmjet procedurës së ankandeve në hije, në kuadër të bashkimit respektiv të tregjeve Shqipëri–Kosovë.” Pas fjalive “Këto procedura rezervë për bashkimin e tregut të ditës në avancë Shqipëri–Kosovë” shtohen fjalët: “dhe elektrike brenda së njëjtës ditë IDA (bashkimit të tregut të energjisë Shqipëri–Kosovë)”.

- Në nenin 1 (Objekti dhe fushëveprimi), pika 1: “Procedurat rezervë, siç përcaktohen këtu, do të konsiderohen si propozim i përbashkët i OST-ve AL-KS për të siguruar alokim efikas, transparent dhe jodiskriminues të kapaciteteve, në rast se procesi i bashkimit të tregut të ditës në avancë nuk është në gjendje, plotësisht ose pjesërisht, të prodhojë rezultate, në përputhje me aktet ligjore, nënligjore, rregullatore dhe marrëveshjet midis OST-ve dhe NEMO-s të Shqipërisë dhe të Kosovës.” Në fund shtohen fjalët: “dhe për IDA (bashkimin e tregut të energjisë elektrike brenda së njëjtës ditë Shqipëri–Kosovë) për një sistem të përbashkët komunikimi rezervë”.

- Këto shtesa dhe ndryshime të propozuara nga OST sh.a. evidentohen si propozime në kuadër të implementimit të tregut të organizuar me shumicë brenda së njëjtës ditë. Shtesat dhe ndryshimet nuk ndryshojnë parimet e metodologjisë në fuqi të miratuara nga ERE, por zgjerojnë fushën e veprimit të saj duke përfshirë edhe tregun brenda së njëjtës ditë të Bursës Shqiptare të Energjisë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në “Procedurat rezervë për bashkimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri–Kosovë”.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti